




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-704/13
Nr. l. faq. Broj stranica 02	Data Datum 08.03.2013
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **06.03.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3638/12, për ztr. Agron Tigani – Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të ujësjellësit “Hidrodrini” Pejë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik duke dhënë dorëheqje nga funksioni tjetër, si Anëtar Bordi i Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambineti” Pejë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3638-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Agron Tigani–Kryeshef i Kompanisë Rajonale të ujësjellësit “Hidrodrini”, dhe Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale “Ambienti” është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3638/12, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. Tigani së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia, (DPK-01-4025-12), e pastaj është paraqitur në një takim me zyrtarët e Agjencisë në të cilën është njoftuar për situatën e papajtueshmërisë që ka në ushtrimin e njëkohësishëm të dy funksioneve të tija publike.

Duke qenë se ushtrimi i njëkohësishëm i këtyre dy detyrave, konform nenit 16 paragrafi 1 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, paraqet situatë të papajtueshme, në takim me zyrtarin Tigani kemi kërkuar që ai të përcaktohet për njëren nga këto dy funksione.

Ztr. Tigani pastaj na është drejtuar edhe me një shkresë zyrtare (DPKI-03-608-13) në të cilën ka sqaruar se është i gatshëm që të dorëhiqet nga funksioni i të qenurit Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambineti”, sepse dëshiron që ta mbajë pozitën e Kryshefit Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të ujësjellësit “Hidrodrini”.

Ndërkohë në Agjencinë kundër Korrupsionit ka ardhë edhe shkresa zyrtare (DPK/DPKI-03-100/2013) e shkruar nga ztr. Agron Tigani me të cilën ai i është drejtuar Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambienti”, Kuvendit Komunal të Pejës (si aksionar) dhe Agjencisë kundër Korrupsionit, duke ofruar dorëheqjen e tij si Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambineti” SH.A, për të vazhduar kontributin e tij profesional si Kryeshef në Kompaninë Rajonale “Hidrodrini” Peje.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

DPK KI 12

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.


Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /



Agjencia Kundër Korrupsionit / Agjencia protiv korupcije / Anti Corruption Agency

www.akk-rks.org ,